

574/3

Nr. 384/1 Prot.

28.3.24

Tiranë, më 26/03/2024

Lënda: **Dërgohen komentet mbi draft metodologjinë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme**

Drejtuar: **Znj. Erjola SADUSHI** ✓  
**Kryetare në detyrë**  
**Enti Rregullator i Energjisë**

Për dijëni: **Z. Enea KARAKAÇI**  
**Administrator**  
**“Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” SH.A.**

*E nderuar znj. Sadushi,*

Në vijim të vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 377, datë 28.12.2023 dhe pas njohjes me draft metodologjinë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, gjeni më poshtë komentet e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., në cilësinë e Furnizuesit dhe të të ngarkuarit me detyrat e OER.

- Në nenin 4, pika 10 parashikohet se, OER ka të drejtë të rikuperojë çdo pagesë të paarkëtuar nga një furnizues i falimentuar, duke i ndarë këto të arkëtueshme të pambledhura me furnizuesit e mbetur në treg, në proporcion me pjesën e tregut që zë secili furnizues. Ndonëse ky përcaktim është edhe në nenin 16 të ligjit Nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, nevojitet të gjendet një mekanizëm që mitigon risqe të tilla duke parashikuar instrumenta financiarë që garantojnë përmbushjen e detyrimeve dhe nuk diskriminojnë furnizuesit e tjerë që operojnë mbi baza korrekte.
- Roli dhe përgjegjësitë e Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me Operatorin e Energjisë së Rinovueshme dhe furnizuesit duhet të parashikohen në një nen të veçantë, kjo pasi drafti i metodologjisë ka përcaktime për Entin Rregullator të Energjisë në disa nene, konkretisht: neni 4 pika 11, neni 5 pika 5 dhe 6, neni 10 pika 1 dhe 2.
- Në nenin 5, pika 1, përcaktohet se furnizuesit e energjisë elektrike do t'i paraqesin OER parashikimin vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të furnizohet prej tyre. Afati i parashikuar në këtë dispozitë duhet të jetë më i vonshëm, pasi kontratat e furnizimit zakonisht janë afatshkurtra deri në një vjeçare dhe vetëm në fund të vitit, furnizuesi mund të parashikojë vëllimin e energjisë elektrike që pritet të furnizojë për vitin pasardhës. Në këto kushte, vlerësojmë se një sistem/mekanizëm që do të funksiononte do të ishte përdorimi i të dhënave historike të klientëve.

- Në nenin 5, pika 2 parashikohet nënshkrimi i një kontrate për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme ndërmjet OER dhe çdo furnizuesi. Nevojitet të përcaktohet nëse kjo kontratë do hartohet dhe miratohet nga ERE.
- Në nenin 6, pika 1, kërkohet nga të gjithë prodhuesit me përparësi në operim si dhe prodhuesit me përparësi të cilët planifikojnë të vënë në funksion impiantet e tyre në vitin pasardhës të paraqesin Operatorit të Energjisë së Rinovueshme parashikimin vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të gjenerohet. Përsëri sikurse edhe komenti për nenin 5, pika 1, vlerësojmë se një sistem/mekanizëm që do të funksiononte dhe më afër realitetit do të ishte përdorimi i të dhënave historike të prodhuesve duke përfshirë elementë parashikimi bazuar në kapacitetet shtesë të planifikuara.

Për sa më sipër, parashikimet e përcaktuara në pikën 1 të neneve 5 dhe 6, paraqesin vështirësi dhe janë subjektive, duke bërë që shmangia nga vlerat faktike e furnizuesve dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike të jetë e konsiderueshme. Për më tepër, duke qënë se metodologjia kërkon të dhëna në nivel orar vështirëson llogaritjen dhe saktësinë e përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme.

- Në nenin 16, pika 7 të ligjit Nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” përcaktohet se: *“Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, duke përfshirë procesin e llogaritjes dhe përditësimit sistematik të fondit të mbështetjes së burimeve të rinovueshme, do të përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministria”*. Në kushtet kur ky vendim ende nuk është miratuar, në dispozitat kalimtare të kësaj metodologjie nevojitet të parashikohet që kjo metodologji të hyjë në fuqi me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave. Pra, vlerësojmë se Vendimi i Këshillit të Ministrave për detyrat dhe përgjegjësitë e OER duhet të eci paralelisht me këtë metodologji.
- Aktualisht, shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe për ta tregtuar këtë energji për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen. Referuar parashikimeve të draftit të kësaj metodologjie, e gjithë energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme duhet të tregtohet në Bursën Shqiptare, ALPEX SH.A., për rrjedhojë edhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A. duhet t’i sigurojë sasi të nevojshme të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në treg.
- Sikurse jeni në dijeni, volumet e energjisë së burimeve të rinovueshme janë të konsiderueshme. Referuar likuiditetit aktual të Bursës Shqiptare, ALPEX SH.A., mund të ndodhë që një pjesë e volumeve të energjisë të mos tregtohen.
- Gjithashtu, në dispozitat kalimtare, propozojmë të parashikohet një periudhë “dry run”, pa efekte financiare, me qëllim që pjesëmarrësit të njihen më mirë me procesin dhe efektet e tij.



Së fundmi, do të vlerësonim zhvillimin i një seance konsultative me shembuj konkretë dhe simulime me të dhëna, për të kuptuar zbatimin dhe efektet e kësaj metodologjie.

Me konsideratë,

**Albi GJENERALI**

**Administrator**

**FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SH.A.**

